

515 PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK

Fusha përmban pikëqasjen për formën e njësuar të emrit të njësisë politike-territoriale ose emrit gjeografik, që është në lidhshmëri me pikëqasjen në fushën 2XX.

Emrat e njësisë politike-territoriale që përdoren si pikëqasje lëndore, të vetme ose vetëm me përcaktuesit e shtuar lëndorë, trajtohen si emra territoresh (fusha 515). Emrat e njësisë politike-territoriale që përdoren si pikëqasje për autorët, trajtohen si organizata (fusha 510). Si organizata trajtohen edhe emrat e njësisë politike-territoriale, pas të cilëve ndodhet nëndarja për organizatën dhe të cilët përdoren si pikëqasje për autorët ose si pikëqasje lëndore.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
515	Pikëqasja në lidhshmëri – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik	r
a	<i>Elementi hyrës</i>	nr
x	<i>Përcaktuesi i përgjithshëm</i>	r
z	<i>Përcaktuesi kohor</i>	r
3	<i>Numri i regjistrimit</i>	nr
5	<i>Kodi për marrëdhënien</i>	nr
9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a është përshkruar tek fusha 215, nënfusha x dhe z në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 3, 5 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban emrin e njësisë politike-territoriale ose emrin gjeografik, i cili është në lidhshmëri me pikëqasjen në fushën 2XX dhe është formuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

215 PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR
GJEOGRAFIK

SHEMBUJ

1.

215	uu	aSri Lanka
515	uu	aCeylon

2.

215	uu	aKabwe (Zambia)
515	uu	5a aBrokes Hill (Zambia)

3. * COBISS.net

152	uu	bsgc
215	uu	aDeti Adriatik
515	uu	3<nnn> 5g aDeti Mesdhe (Deti Mesdhe është term i gjerë për termin Deti Adriatik.)

4. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	aGjuhët sllave
515	uu	3<nnn> 5z aShtetet sllave
550	uu	3<nnn> 5g aGjuhët balto-sllave
550	uu	3<nnn> 5g aGjuhët indoevropiane
550	uu	3<nnn> 5z aShkrimi cirilik
550	uu	3<nnn> 5z aAlfabeti glagolitik
550	uu	3<nnn> 5z aPansllavizmi
550	uu	3<nnn> 5z aSllavistika
550	uu	3<nnn> 5z aEmrat sllavë
550	uu	3<nnn> 5z aLetërsia sllave
550	uu	3<nnn> 5z aDorëshkrimet sllave (Termi Shtetet sllave në fushën 515 është term në lidhshmëri me termin Gjuhët sllave.)

5. * COBISS.net

152	uu	bsgc
215	uu	aShtetet sllave
515	uu	3<nnn> 5z aEvropa Lindore
550	uu	3<nnn> 5z aSllavët
550	uu	3<nnn> 5z aStudimet sllave
550	uu	3<nnn> 5z aGjuhët sllave (Termi Evropa Lindore në fushën 515 është në lidhshmëri me termin Shtetet sllave.)